

**FUNCTIONS OF FLORA IN SOME CHILDREN'S LITERARY
CREATIONS BY REXHEP HOXHA**
**FUNKSIONET E FLORËS NË DISA KRIJIME LETRARE TË REXHEP
HOXHËS**

Jehona RUSHIDI-REXHEPI¹, Besnik REXHEPI²

^{1*} Department of Teacher Education, Faculty of Pedagogy, University of Tetova

² Department of Biology, Faculty of Natural Sciences and Mathematics, University of Tetova

*Corresponding author e-mail: jehona.rushidi@unite.edu.mk

Përmbledhje

Përveç lidhjeve të tjera që vendos një vepër letrare, një dukuri e shpeshtë por jo e studiuar aq sa duhet është raporti mes letërsisë dhe etnobotanikës. Në letërsinë shqiptare shembuj të krijimeve letrare ku vërehet pjesëmarrja e florës, janë të dukshëm sidomos në letërsinë për fëmijë. Kjo e fundit, si letërsi e shkruar për lexuesin fëmijë, kemi parasysh se u nënshtrohet disa kriterëve dhe kërkesave pedagogjike. Një karakteristikë e këtillë është prania e informacionit shkencor, parimit të vërtetësisë dhe të ngjashme. Ky punim paraqet një marrëdhënie unike simbiotike mes letërsisë dhe etnobotanikës.

Shembujt në këtë punim janë tërhequr kryesisht nga një përzgjedhje e dy librave nga Rexhep Hoxha (1929-2019) për të sugjeruar që pjesa e funksioneve të florës (veçanërisht etnotaksonomia) në letërsinë për fëmijë mund të shihet në pozitë aktive (dinamike) dhe pasive (statike). Është vënë re se shumica e shembujve statikë të bimëve janë të lidhur me shkurre dhe barishte (*Juniperus communis*, *Primula veris*, etj), ndërsa shembujt dinamikë janë të lidhur me drunjt (*Quercus sp.*, *Betula pendula*, *Fraxinus sp.*, etj) dhe peisazhe (rurale, kulturore dhe bujqësore). Këto të fundit tregohen si aktive sepse marrin pjesë në vetë veprimin, duke ndihmuar protagonistët në veprimet e tyre, në mënyra të ndryshme.

Fjalët kyçe: *Letërsia shqiptare për fëmijë, etnobotanika, flora, statik, dinamik.*

1. Hyrje

Analiza e krijimeve letrare për fëmijë, mbështetur në nënvijëzimin e formave në të cilat paraqitet flora, në traditën tonë të studimeve letrare, mendojmë se është e rrallë. Duke e parë këtë çështje si jo aq të thjeshtë dhe njëkohësisht pak të prekur, qëllimi i këtij punimi është që nëpërmjet analizës së veprave të caktuara të letërsisë për fëmijë të bëhet ndërlidhje e dy lëmenjve, gjegjësisht të ndërlidhen aspekte teorike të letërsisë për fëmijë me etnobotanikën. Për të filluar me hulumtim të këtij tipi, natyrisht që i vlefshëm është mendimi ekzistues teorik që lidhet me letërsinë për fëmijë, ndërsa shembujt e pjesës analitike të punimit do të jepen nga dy romane për fëmijë, të shkrimtarit të njohur Rexhep Hoxha: “Lugjet e verdha” dhe “Verorja”.

Letërsia për fëmijë, natyrisht që nuk mundet të përjashtojë e të kufizojë tema që i ka letërsia për të rritur, por megjithatë në një mënyrë të natyrshme disa i mban si brum të vetin. Në këtë drejtim mund të përmenden më shumë detaje, mirëpo ky studim mëton të ndalet dhe të thellohet në gjetjen e formave të florës, gjegjësisht pozitës së saj dhe funksioneve në veprat e lartpërmendura. Përveç kësaj s'ka mëdyshje se letërsisë për fëmijë i shkojnë të ngjitura mjaft kërkesa pedagogjike e psikologjike, të cilat e modelojnë në një farë mënyre një tematikë të caktuar e cila ndoshta në një formë tjetër, pa ndryshuar në thelb, qarkullon dëndur edhe në letërsinë për të rritur.

Në studimet mbi letërsinë për fëmijë i është kushtuar kujdes florës dhe faunës në letërsi (në një masë dukshëm më të vogël se sa për dukuritë tjera). P.sh., Astrit Bishqemi (Letërsi për fëmijë, 1997) flet për rëndësinë e florës dhe faunës në letërsi, mirëpo këtu qasja nuk është ndërdisiplinare meqë bëhet fjalë për studim të fushës pastër të letërsisë. Informacioni etnobotanik përfshin shembuj interesantë të bimëve në kulturën materiale, bimëve që përdoren për mjekim, bimëve ushqyese, etj. Lidhur me fushën e etnobotanikës do të jepen të dhëna si dhe informacione të tjera (vendbanimi i bimëve, etnotaksonomia, ekosistemi, etj). Së këndejmi, do të nënvijëzohen emra realë dhe fiktivë të bimëve si dhe pozita e tyre aktive dhe pasive, personifikimi dhe antropomorfizmi, përfshirja e peisazheve, vërtetësia e informacionit, bazuar e gjithë kjo në parimet pedagogjike që dalin para letërsisë për fëmijë.

2. Metodat

Punimi ka pjesë teorike dhe aplikative. Duke dashur të nënvijëzohet rëndësia e njohurive tradicionale etnobotanike në romanet “Verorja” dhe “Lugjet e verdha” të Rexhep Hoxhës, u përdor metoda deskriptive. Qasja e analizës letrare do të jetë e jashtme dhe e brendshme, ndërsa plani i ndjekur është i natyrës deduktive.

3. Flora në letërsinë për fëmijë shikuar nga aspekti teorik letrar dhe kërkesat pedagogjike

Këtë aspekt do ta analizojmë fillimisht nga studimet paraprake. Studiuesi Astrit Bishqemi (1997) në studimin e tij “Letërsi për fëmijë”(Pjesa I-Teoria, 1997), florën dhe faunën i sheh në shtrirjen që kanë në prozë dhe poezinë për fëmijë. Ai shprehet: “Personazhët fëmijë spontanisht do të kontaktojnë me jetën në natyrë, ashtu si ngjet edhe në jetën reale. E natyrshme do të jetë edhe dashuria e tyre ndaj bimëve dhe gjallesave përmes të cilave do t'u bëhet i afërt pylli, livadhi, lugina, lumi, etj..”

Pozitën e florës ky studiues e sheh në dy forma, si: statike dhe dinamike. Në pozitë statike i sheh kryesisht bimët vaskulare (barishtet, vjollcat, karafilat, etj.). Pozita statike shihet si relative pasi ato janë element estetik por funksionin e kanë të efektshëm. Pozita tjetër, dinamike, përfshin bimët e larta, drunjët në pyje, plepat. Këto, kanë rol dinamik aktiv pasi marrin pjesë në vetë veprim, e ndihmojnë protagonistin në forma të ndryshme. Të dyja këto funksione gjenden të pranishme edhe në poezinë për fëmijë dhe sipas studiuesit Astrit Bishqemi (1997), flora ka shpesh pozitë idilike-ekzotike dhe zakonisht ndihmon për të realizuar një ide të dytë.

4. Karakteristikat e florës në romanet “Lugjet e Verdha” dhe “Verorja”

Sinjalet e para që na bënë ta përzgjedhim krijimtarinë e Rexhep Hoxhës si shtrat i mirë shembujsh, është pikërisht mbështetja në letërsinë popullore, folklor, në kombinimet e magjikes dhe fantastikes. Duke i pasur parasysh këto elemente, ishte e qartë që studiuesi, kur niset nga këndvështrim si ky i punimit tonë, mbetet duarplot. E kemi parasysh se te letërsia për fëmijë nuk parapëlqehen përshkrimet e gjata, të cilat zakonisht na asociojnë në pjesën hyrëse të një veprë. Te krijimet që ne i marrim si shembuj, realizimi i paraqitjes së veprimit, kryhet me një efektshmëri të madhe dhe pikërisht këtu, mes përshkrimit të peisazhit i gjejmë segmentet e rëndësishme për ne. Të numërojmë shembuj:

➤ “Toka pjellore e tij, me ara, livadhe, kopshtije, pyje e ujëra të kthjellëta sikurse ari, i kishte pas bërë të pasur e të lumtur shumicën e banorëve. Çdo pranverë kishte pas qeshë fusha e Armjetit. Kishte pas qeshur një nuse e stolisur, me lule e gjelbërime” (Hoxha, 2015).

➤ “Kudo ka hapur krahët skorleqi, ka ngritur ballin sjerrusha, është hapur me gjethe rrusharusha, megjeve të arave ka kapluar kapinoku, skaj ledhesh është mbushur lulkatuja, lashagjela, syunaza, nëpër firaja e toka të hapuna duken si në valle aguliqet e bukura, luledelet, marangjylat e lloj-lloj lulesh të tjera të bukurisë së pranverës (Hoxha, 2015).

Kryesisht, numërimi i bimëve bëhet në shumë raste i përsëritur, por me informacione që e shoqërojnë (tregohet koha kur ato lulëzojnë, lidhen me një rit pagan ose bestëtytni). Në numrin më të madh të shembujve vërehet pozita statike, por jo si absolute, pasi roli në përcjelljen e mesazhit, kompletimin e pamjes dhe veprimit është i dukshëm.

Kundër mësyshit, po paraqesim shembuj tjerë:

➤ “Ermira sa mund u fërfëllon mbi kokë lule të shëngjergjit, milic, lulkatuja e shkamos, shkamos lule e barishte të tjera të pranverës”; (Hoxha, 2015).

➤ “Dita e Shëngjergjit ka një javë që ka kaluar. Ende nuk janë vyshkur rrembat e shelnjeve, që njerëzit i patën vënë nëpër dyer shtëpiash e kasollesh, hambarësh e koçakesh, nëpër ahrije e stele për ditën e Shëngjergjit. Ende amson lulkatuja, mokthi, millci, barshëngjergji dhe lulet dhe barishtet e tjera që shpezët i kanë shtruar nëpër çerdhet e tyre për festën e madhe të pranverës.” (Hoxha, 2015).

Funksioni i florës nuk është i tillë që përmbush didaktizmin e tepruar, të vjetëruar apo ndonjë moralizim të thatë. Kjo vërehet në shembujt e mëposhtëm:

➤ “Unë zura vend mbi një shelnje, e dini? - mbi një shelnje plot me bilanjok, mos të më shohin. Edhe...” (Hoxha, 2015).

➤ “Rruga ishte bukur e gjatë deri atje. Plot çutra, prroje, lumenj, kodra, brigje, pyje. Plot ferra, egërsira, vuajtje, mundime” (Hoxha, 2015).

➤ A po i sheh ato pemishte të ngritura nga puna e madhe e njeriut, ato vreshta dhe arrishte, ata lumenj te kulluar e gurra të cemta që i japin jetë e hijeshi atij krahu? (Hoxha, 2015).

➤ “Prej dritarësh hapet një lulishte me gjithëfarë lulesh, nga më të zgjedhurat në gjithë gjihanin, trëndafila të shamit, karajfila topali të Axhemit, mërsina, mirta, anemone, narcisë, mimoza (Hoxha, 2015).

Informacioni i veprës letrare, është një tjetër kërkesë pedagogjike. Në këtë, drejtim nga përsëritjet (me gjasa të qëllimshme) të emërtimit të bimëve, nga shembujt e mësipërm ku vetë narratori jep sqarime plotësuese, duket që ky kriter është përmbushur.

Tabela 1. Elementet e florës në romanin “Verorja” dhe “Lugjet e verdha”.

Bimët në kulturën materiale	Kurse Shpendi kishte vetëm një thupër të hollë <u>frashëri</u> (<i>Fraxinus sp</i>)
Peisazhe	Sepse, vetë natyra me duart e saja të arta e kishte krijuar atë luginë, ato lugje, në daç për kullosa me bar rudaci deri në gju, në daç me kroje e gurra, me ujëra të kulluara sikurse loti.
Ekosisteme	Toka pjellore e tij, me ara, livadhe, kopshtije, pyje e ujëra të kthjellëta sikurse ari, i kishte pas bërë të pasur e të lumtur shumicën e banorëve.
Vendbanime	Livadh, pyll, drunjtë e pyllit.
Emra shkencorë dhe vendorë të bimëve të përmendura	Në atë zgurojë shkëmbi, përreth me <u>dëllinja</u> (<i>common juniper</i>), <u>mështeka</u> (<i>European white birch</i>). Shelnja (<i>Salix sp</i>) Thana (<i>Cornus mas</i>) Dëllinja (<i>Juniperus communis</i>) Meshtekna (<i>Betula pendula</i>) Lisi (<i>Quercus sp</i>) Hithra (<i>Urtica dioica</i>) Lule shengjergji (<i>Primula veris</i>) Madergona ose kakanidël (<i>Mandragora sp</i>) Mrizi (<i>Crataegus monogyna</i>) Dru pishash (<i>Pinus sp</i>) Frasher (<i>Fraxinus sp</i>) Memekuqe (netlla) <i>Bassia scoparia</i> ose <i>Sorghum vulgare</i> ; Saruzhë (<i>Stachys sp</i>) Arashkë (<i>Beta vulgaris</i>) Kakudë (<i>Conium maculatum</i>) Shkozë (<i>Carpinus sp</i>)
Toponimet	Delet kullotnin. Mall, mall po i afroreshin <u>Shelnjës së Shytit</u> , <u>Bregu i thanës</u> , <u>Lisat e qyqes</u>

3. Përfundimi

Flora dhe letërsia japin mundësi të shumta të analizave të këtilla, mundësojnë ndërlidhje mes fushave shkencore, japin mundësinë e qasjeve hibride. Së këndejmi, ky studim u orvat të tregojë se kjo qasje ishte e mundur, duke shpresuar të ketë qenë e frytshme, qasje që shfrytëzoi të dhëna nga etnobotanika, letërsia për fëmijë, gjegjësisht mes shkencave humane dhe shoqërore.

Duke pasur parasysh lashtësinë e përdorimit të bimëve në kuptimin e tyre simbolik, ishte e vështirë për t’i përcaktuar shembujt e pjesës aplikative. Duke marrë parasysh që rezultatet duhet të ishin të plota dhe të ndryshme, aq sa është e mundur, si dhe duke i shtuar vlerë qasjes ndërdisiplinare, shembujt nga proza për fëmijë të Rexhep Hoxhës u vlerësuan si të përshtatshëm. Arsyeja e parë është mbështetja në folklor dhe mitologji si një burim i pasur, arsyeja e dytë është karakteri edukativ i kësaj letërsie dhe përshtatja me kërkesat pedagogjike, natyrisht jo në ekstremin që shihet si i dëmshëm (lexuesi merr informacion dhe realizohet funksioni estetik).

Në hulumtimin tonë, flora siguroi mundësinë e marrjes dhe realizimit të informacionit real shkencor, mundësinë e realizimit të ndjenjës estetike; ajo kryente funksionin e përshkrimit efektiv, por nuk manifestohet si e personifikuar. Roli statik duhet të shihet si relativ, por edhe roli dinamik nuk është i skajshëm. Shumica e specieve të cituara ishin specie të njohura nga etnobotanika shqiptare, ndonjëherë me emër të ndryshuar (por me shpjegimin e autorit), pa harruar që dallohen edhe shembuj fiktivë.

Referencat

- [1]. Bishqemi, A. (1997): Letërsi për fëmijë (Pjesa I: Teoria). Sejko, Elbasan, f.143-147.
- [2]. Hoxha, R. (2015): Lugjet e verdha (Pjesa I). Sh.B. Lugjet e verdha. Prishtinë, f.7, 39, 41, 61.
- [3]. Hoxha, R. (2015): Lugjet e verdha (Pjesa II). Sh.B. Lugjet e verdha. Prishtinë, f.3, 154.
- [4]. Hoxha, R. (2015): Verorja. Sh.B. Lugjet e verdha. Prishtinë, f, 98.
- [5]. Rexhepi B., Bajrami A., Mustafa B. (2018): Three Ethnic groups, One Territory: Perspectives of an ethnobotanical study from Southwestern Macedonia. International Journal of Education, Science, Technology, Innovation, Health and Environment. Vol. 04 (1).
- [6]. Rexhepi, B.; Mustafa, B.; Hajdari, A.; Rushidi-Rexhepi, J.; Quave, C.L. & Pieroni, A. 2013. Traditional medicinal plant knowledge among Albanians, Macedonians and Gorani in the Sharr Mountains (Republic of Macedonia). Genetic Resources and Crop Evolution 60.